




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO-REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E SUHAREKËS
MUNICIPALITY OF SUHAREKA-OPSTINE SUVA REKA



ZYRA E PROKURIMIT

Nr. 24/2020

Nr. Protokolli: 34/2021

Për:	EBK Sh.P.K”, “ G-Projekt Sh.P.K”, “ Seferi-Co Sh.P.K”, “ Vehbi Mamaj B.I”
Kopje:	z.Bali Muharremaj, Kryetar i Komunës së Suharekës
Nga:	Afrim BYTYQI, u.d. Shef i Prokurimit
Lënda:	VENDIM
Datë:	19.04.2021

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Suharekës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 7 (paragrafi 7.1 pika a) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, sipas **kërkesës për ri-shqyrtim** të datës 16.04.201 të parashtruar nga Operatori Ekonomik: **EBK Sh.P.K”, “ G-Projekt Sh.P.K”, “ Seferi-Co Sh.P.K”, “ Vehbi Mamaj B.I”**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **“Ndërtimi i rrugës Baqevc-Sallagrazhde-Grejkoc-Korishë, Suharekë”** me Nr. të Prokurimi: **624-21-1475-5-2-1& 624-021-069-521** nxjerr këtë:

V E N D I M

- Aprovohet Pjesërsht** kërkesa për ri-shqyrtim e datës 16.04.2021 të parashtruar nga Operatori Ekonomik: lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **“EBK Sh.P.K”, “ G-Projekt Sh.P.K”, “ Seferi-Co Sh.P.K”, “ Vehbi Mamaj B.”** lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull **Ndërtimi i rrugës Baqevc-Sallagrazhde-Grejkoc-Korishë, Suharekë”** me Nr. të Prokurimi: **624-21-1475-5-2-1& 624-021-069-52,**
- Plotësim - Ndryshimi** është bërë sot me date 19.04.2021 përmes formularit B54 në platëformën elektronike e-prokurimi, e poashtu është harmonizohuar edhe data e hapjes konform dispozitave ligjore të LPP-së.
- Kërkesat tjera mbeten të pandryshuara dhe se Autoriteti Kontraktues, vendos që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit.
- Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platëformën elektronike në adresën: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

A r s y e t i m

Autoriteti Kontraktues, Komuna Suhareke me datë 16.04.2021 ka pranuar kërkesat për ri-shqyrtim nga Operatoret Ekonomik **EBK Sh.P.K**”, “ **G-Projekt Sh.P.K**”, “ **Seferi-Co Sh.P.K**”, “ **Vehbi Mamaj B.I**”, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “**Ndërtimi i rrugës Baqevc-Sallagrazhdë-Grejkoc-Korishë, Suharekë**” me Nr. të Prokurimi: **624-21-1475-5-2-1& 624-021-069-521** të cilat kanë të bëjnë me kriterin te kapaciteti teknik profesional saktësisht te Injiniери i infrastruktures rrugore, ku është kërkuar që të ulet përvoja e punës pas diplomimit nga 5 vite në 3 vite përvojë pune. Ak- Suharekë, bazuar në dispozitat ligjore të LPP-së, dhe RrUOP-së, për të krijuar hapsirë më të madhe për pjesëmarrje vendosi që të ulë përvojen e punës pas diplomimit nga 5 vite në 3 vite pune për Injiniери i Ndërtimtarisë Bachelor ose Master – drejtimi infrastrukture rrugore.

Ndryshime kanë ndodhur në platformen elektronike me date 19.04.2021, konform dispozitave ligjore përmesë formularit B54.

Andaj bazuar në të cekurat më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. Ankesa pranë OSHP-së duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjetë) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.

u.d. Shefi i Prokurimit
Arim BYTYQI

